

# KONTRATË SHITBLERJEJE PJESËSH KAPITALI

Sot, më datë 14.02.2003, në orën 14:00, përpara meje Noteres duzi Gjilica, Anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, u lidh kjo kontratë shitblerjeje pjesësh kapitali (më poshtë quajtur "Kontrata"),

*midis*

Z. **Gianfranco LIUZZI**, qytetar italian, lindur në Locorotondo (BA), Itali, më 06.04.1947 dhe banues në Bari (BA), Itali, në Viale della Repubblica n.71/G, mbajtës i pasaportës nr. 804081, në cilësinë e ortakut të Shoqërisë Teknotrade Sh.p.k. zotërues i 60% të kapitalit të Shoqërisë (në vijim "Shitësi");

*dhe*

Shoqëria **The Point sh.p.k.**, shoqëri e së drejtës shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Gjykatën e Tiranës me vendimin nr. 26446, datë 15.10.2001, me seli në Rruga Myslym Shyri, Pall.7, Shk. 5, Ap.50, Tiranë, e përfaqësuar nga Znj. Evis Frashëri, qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 05.04.1972, banuese në Rruga Myslym Shyri, Pall.7, Shk. 5, Ap.50, Tiranë, mbajtëse e pasaportës nr. 0292917, (në vijim "Blerësi", dhe së bashku me "Shitësin" referuar si "Palët").

## Kushtet Paraprake

- Shitësi është zotërues i një kuote pjesëmarrjeje (Pjesëmarrja) në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar Teknotrade Sh.p.k. me seli në Tiranë, Shqipëri, regjistruar në Gjykatën e Tiranës me Vendimin nr. 7662 datë 10.10.1993 (në vijim "Shoqëria") të barabartë me 60 % (gjashtëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Blerësi ka shprehur interesimin e tij për të blerë 11% të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë që janë në pronësi të Shitësit dhe Shitësi ka shprehur gatishmërinë e tij për të transferuar këtë përqindje.

*Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, palët bien dakord sa më poshtë vijon:*

### Neni 1 - Kushtet Paraprake

Kushtet paraprake dhe shtojcat janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

### Neni 2 - Objekti i Kontratës

Shitësi i shtet Blerësit, që blen, 11% (njëmbëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të së drejtës shqiptare Teknotrade Sh.p.k..

### **Neni 3 – Çmimi dhe mënyra e pagesës**

Çmimi i shitjes së pjesëve të kapitalit të Shoqërisë është 2.000 (dymijë) USD.

Shitësi deklaron se çmimi i shitjes së pjesëve të kapitalit të Shoqërisë, për të cilat ai është pronar, është paguar tërësisht nga Blerësi përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate.

### **Neni 4 - Të Drejtat dhe Detyrimet e Shitësit**

- 4.1 Shitësi deklaron se pjesët e kapitalit që i shiten Blerësit janë plotësisht të lira nga çdo barrë, apo detyrim në favor të të tretëve, dhe merr përsipër të mos i shkaktojë dëme Blerësit të dëmshpërblejë atë për çdo dëm apo humbje të pësuar nga ky i fundit nga pretendimet e të tretëve ndaj pjesëve shitura të kapitalit.
- 4.2 Shitësi deklaron gjithashtu se ka përmbushur çdo detyrim, që rrjedh nga cilësia e të qenit ortak në Shoqëri, në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate. Në rast mospërmbushje të këtij detyrimi, Shitësi merr përsipër të dëmshpërblejë Blerësin për çdo dëm apo humbje, pasojë e mospërmbushjes.

### **Neni 5 - Të Drejtat dhe Detyrimet e Blerësit**

Tatimet, taksat e pullës dhe shpenzimet ligjore dhe noteriale që lidhen me nënshkrimin e kësaj Kontrate do të jenë në ngarkim të Blerësit.

### **Neni 6 - Përmbajtja e Kontratës dhe ndryshimet**

Kjo Kontratë përfshin tërësisht marrëdhëniet midis palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparëshme me këtë objekt. Ndryshimet apo shmangiet e mundshme nga kjo Kontratë, mund të bëhen vetëm me shkrim, të nënshkruhen nga të gjitha palët dhe më pas t'i bashkëngjiten kësaj Kontrate.

### **Neni 7 - Korrespondenca**

- 7.1 Të gjitha lajmërimet, kërkesat dhe njoftimet e tjera mes palëve, duhet të bëhen me shkrim dhe të dërgohen në adresat e mëposhtme:
  - (i) për Shitësin: Viale della Repubblica n. 71/G, Bari (BA), Itali.
  - (ii) për Blerësin: Rruga Myslym Shyri, Pall. 7, Shk. 5, Ap. 50, Tiranë, Shqipëri.
- 7.2 Lajmërimet, kërkesat dhe njoftimet e tjera do të dërgohen me letër rekomande ose me faks.
- 7.3 Çdo informacion, kërkesë apo njoftim do të ketë fuqi vetëm nëse plotëson kushtet e mëposhtme: a) dërgohet me faks, dhe do të ketë fuqi në momentin në të cilin merret faksi; b) dërgohet me letër rekomande, dhe do të ketë fuqi në datën e marrjes, që rezulton nga firmosja e marrjes në dorëzim.

**Neni 8**  
**Legjislacioni i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Kjo Kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar.

8.2

Çdo mosmarrëveshje midis palëve që rrjedh apo lidhet me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Kontrate, e cila nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim mes palëve, do t'i kalohet për zgjidhje Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

**Neni 9 - Gjuha e Kontratës**

Kjo Kontratë është përgatitur në 4 (katër) kopje në gjuhën italiane dhe të përkthyer në gjuhën shqipe. Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Kontrate, versioni italisht do të mbizotërojë dhe do të jetë i vetmi me fuqi ligjore.

\*\*\*

Unë Noterja, ia lexova palëve këtë Kontratë, të cilat deklaruan se e gjejnë atë plotësisht në përputhje me vullnetin e tyre dhe e nënshkruan në praninë time, dhe Unë Noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

**Shitësi**

(nënshkrimi)

**Blerësi**

(nënshkrimi)

NOTERJA  
LIRI GJOLIKU  
TIRANË  
*my*

## KONTRATË SHITBLERJEJE PJESËSH KAPITALI

Sot, më datë 14.02.2003, në orën 14<sup>00</sup>, përpara meje Noteres Alta Gjokaj  
Ahëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, u lidh kjo kontratë shitblerjeje pjesësh kapitali  
(më poshtë quajtur "Kontrata"),

*midis*

Zj. **Angela Campanella** (në vijim "Shitësi"), qytetare italiane, lindur në Locorotondo (BA), Itali, më 21.05.1948 dhe banuese në Bari (BA), Itali, në Viale della Repubblica n.71/G, mbajtëse e pasaportës nr. 804082, në cilësinë e ortakes së Shoqërisë "Teknotrade" Sh.p.k. zotëruese e 40% (dyzet përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, e përfaqësuar në këtë mbledhje nga Z. **Gianfranco LIUZZI**, qytetar italian, lindur në Locorotondo (BA), Itali, më 06.04.1947 dhe banues në Bari (BA), Itali, në Viale della Repubblica n.71/G, mbajtës i pasaportës nr. 804081, në bazë të Prokurës së Posaçme të noterizuar nga Noteri Arcangelo Rinaldi, bashkëngjitur (Shtojca A);

*dhe*

Z. **Geront SELENICA**, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 20.5.1966, e banues në Rruga Myslym Shyri, Pall.7, Shk. 5, Ap.50, mbajtës i pasaportës nr. 1088630, (në vijim "Blerësi", dhe së bashku me "Shitësin" referuar si "Palët").

### Kushtet Paraprake

- a) Shitësi është zotërues i një kuote pjesëmarrjeje (Pjesëmarrja) në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar Teknotrade Sh.p.k. me qendër në Tiranë, Shqipëri, regjistruar në Gjykatën e Tiranës me Vendimin nr. 766/19.10.1993 (në vijim "Shoqëria") të barabartë me 40 % (dyzet përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- b) Blerësi ka shprehur interesimin e tij për të blerë Pjesëmarrjen e Shitësit dhe Shitësi ka shprehur gatishmërinë e tij për të transferuar Pjesëmarrjen e treguar në pikën a).

*Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, palët bien dakord sa më poshtë vijon:*

### Neni 1 - Kushtet Paraprake

Kushtet paraprake dhe shtojcat janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

### Neni 2 - Objekti i Kontratës

Shitësi i kalon Blerësit, që blen, kuotën e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të së drejtës shqiptare Teknotrade Sh.p.k. Kjo kuotë pjesëmarrjeje është e barabartë me 40% të kapitalit të Shoqërisë.

### **Neni 3 – Çmimi dhe mënyra e pagesës**

3.1. Çmimi i shitjes së kuotës së Shoqërisë që është në pronësi të Shitësit është 10.000 (dhjetëmijë) USD.

3.2. Shitësi deklaron se çmimi i shitjes së kuotave të Shoqërisë, për të cilat ai është pronar, është paguar tërësisht nga Blerësi përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate.

### **Neni 4 - Të Drejtat dhe Detyrimet e Shitësit**

4.1 Shitësi deklaron se kuota që i kalohet Blerësit është plotësisht e lirë nga çdo barrë, apo detyrim në favor të të tretëve, dhe merr përsipër të mos e dëmtojë dhe të shpërblejë Blerësin për çdo dëm apo humbje të pësuar nga ky i fundit nga pretendimet e të tretëve ndaj kuotës.

4.2 Shitësi deklaron gjithashtu se ka përmbushur çdo detyrim, që rrjedh nga cilësia e të qënurit ortak në Shoqëri, në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate. Në rast mospërmbushje të këtij detyrimi, Shitësi merr përsipër të mos e dëmtojë dhe të shpërblejë Blerësin për çdo dëm apo humbje, pasojë e mospërmbushjes.

### **Neni 5 - Të Drejtat dhe Detyrimet e Blerësit**

Tatimet, taksat e pullës dhe shpenzimet ligjore dhe noteriale që lidhen me nënshkrimin e kësaj Kontrate do të jenë në ngarkim të Blerësit.

### **Neni 6 - Përmbajtja e Kontratës dhe ndryshimet**

Kjo Kontratë përfshin tërësisht marrëdhëniet midis palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparëshme me këtë objekt. Ndryshimet apo shmangiet e mundshme nga kjo Kontratë, mund të bëhen vetëm me shkrim, të nënshkruhen nga të gjitha palët dhe më pas i bashkëngjiten kësaj Kontrate.

### **Neni 7 - Korrespondenca**

7.1 Të gjitha lajmërimet, kërkesat dhe njoftimet e tjera mes palëve, duhet të bëhen me shkrim dhe të dërgohen në adresat e mëposhtme:

- (i) për Shitësin: Viale della Repubblica n. 71/G, Bari (BA), Itali.
- (ii) për Blerësin: Rruga Myslym Shyri, Pall. 7, Shk. 5, Ap. 50, Tiranë, Shqipëri.

7.2 Lajmërimet, kërkesat dhe njoftimet e tjera do të dërgohen me letër rekomande ose me faks.

7.3 Çdo informacion, kërkesë apo njoftim do të ketë fuqi vetëm nëse plotëson kushtet e mëposhtme: a) dërgohet me faks, dhe do të ketë fuqi në momentin në të cilin merret faksi; b) dërgohet me letër rekomande, dhe do të ketë fuqi në datën e marrjes, që rezulton nga firmosja e marrjes në dorëzim.

**Neni 8**  
**Legjislacioni i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

8.1. Kjo Kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar.

8.2. Çdo mosmarrëveshje midis palëve që rrjedh apo lidhet me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Kontrate, e cila nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim mes palëve, do t'i kalohet për zgjidhje Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

**Neni 9 - Gjuha e Kontratës**

Kjo Kontratë është përgatitur në 4 (katër) kopje në gjuhën italiane dhe të përkthyer në gjuhën shqipe. Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Kontrate, versioni italisht do të mbizotërojë dhe do të jetë i vetmi me fuqi ligjore.

\*\*\*

Unë Noterja, ia lexova palëve këtë Kontratë, të cilat deklaruan se e gjejnë atë plotësisht në përputhje me vullnetin e tyre dhe e nënshkruan në praninë time, dhe Unë Noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

I bashkëngjiten kësaj Kontrate:

- 1) Prokura e posaçme e lëshuar nga Znj. Angela Campanella për Z. Gianfranco Liuzzi më 04.11.2002.

**Shitësi**

(nënshkrimi)

**Blerësi**

(nënshkrimi)

NOTERE  
GJOLIKU  
TIRANE  
DM